

KONTRATË SHITJE KUOTE

Sot, me 04.10.2022 (dymije e njezete e dy), palet e meposhtme:

Shitësi: Znj. **Relianda Zhelegu**, atësia Viktor, amësia Dhurata, shtetase Shqiptare, lindur në Gjirokastrë dhe banuese në TIRANË, me adresë Margarita Tutulani; Nd. 1; H. 29; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 15/04/1979, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034179939 dhe nr. personal H95415207H;

dhe

Blerësi: **Vikjana Kocali**, atësia Skënder, amësia Alma, shtetase Shqiptar, lindur në Progonat, Tepelenë dhe banues në Tiranë, me adresë Don Bosko Pall.Ermira Shk.1 Ap.; Nd. 6; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 0000; Tiranë, lindur më 20/08/1998, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033069876 dhe nr. personal J85820024N;

MEQENESE:

- A. Shoqëria "Infinity Destinations" Sh.P.K. (ne vijim "**Shoqeria**"), shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar e qe funksionon ne perputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me Numer Unik Identifikimi NUIS M11921027K, me kapital themeltar prej 100,00 Lekë, sikurse rezulton nga regjistrimet në Regjistrin Tregtar, Shitesja Relianda Zhelegu zoteron 1 (nje) kuote qe perfaqeson 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise;
- B. Shitesi deshiron t'i shese Bleresit dhe Bleresi deshiron te bleje nga Shitesi kuotat e kapitalit qe Shitesi zoteron ne kapitalin e Shoqerise, gjithsej 100% te Kapitalit te Shoqërisë së lartpërmendur, konkretisht 1 (nje) kuote te zoteruar nga Shitesja Relianda Zhelegu;
- C. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, si dhe me vendimin bashkelidhur te Ortakut te Vetem te Shoqerise dhe te bleresit, Palet deshirojne te lidhin kete Kontrate.

PER SA ME SIPER, palët bien dakord si vijon:

1. Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Shitesi i shet Bleresit dhe Bleresi blen nga Shitesi 100% te kapitalit te Shoqerise "INFINITY DESTINATIONS" Sh.P.K. Shitësi deklaron dhe garanton se ka marrë nga Blerësi, në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord prej 100 Leke (njëqind leke) perpara nenshkrimit te kontrates dhe për këtë arsye transferon këtu kuoten e zoteruar prej tij në Kapitalin e Shoqërisë në pronësi të Blerësit. Shitesi deklaron e garanton se nuk ka asnje pretendim te cfaredolloji ne lidhje me pagimin e cmimit te shitjes dhe shprehimisht heq dore nga cdo pretendim i mundshem. Palet deklarojne e garantojne

reciprokisht njera-tjetren se cmimi i shitjes se kuotes eshte i drejte, i arsyeshem dhe i caktuar me vullnetin e lire e te plote te paleve.

2. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se pjeset e kapitalit te transferuara ketu, janë ne pronesine e tij te plote e ligjore dhe te lira nga barra hipoteke apo pengje.
3. Me nenshkrimin e kesaj kontrate ortake e vetme e shoqerise behet Vikjana Kocali, e cila do te zoteroje 1(nje) kuote e cila perfaqeson 100 % (njqind perqind te kapitalit) te shoqerise;
4. Bleresi blen 100 % te kapitalit te Shoqerise dhe me nënshkrimin e kësaj Kontrate behet ortak i vetem i Shoqerise. Blerësi pranon pronësinë e Kuotes duke njohur gjendjen e Shoqerise dhe bie dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i kuotes, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit.
5. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit te Kuotes objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare e Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër Shqiptar sipas përcaktimeve të ligjit.

Kjo Kontrate u hartua në 3 (tri) kopje origjinale ne gjuhen Shqipe. Kontrata bazohet në nenin 705 e vijues të Kodit Civil dhe në Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar. Palet deklarojne se nenshkruajne me vullnet te lire e te plote rregullisht sipas ligjit.

PALET

SHITESI

Relianda Zhelegu

Relianda Zhelegu

BLERESI

Vikjana Kocali

Vikjana Kocali